Duke vlerësuar se paragrafi i dytë i preambulës së Marrëveshjes mes palëve të Traktatit të Alantikut Verior, që ka të bëjë me Statusin e Forcave të tyre, nënshkruar në Londër më 19 qershor 1951 (që tani do të quhet Marrëveshja e Statusit të Forcave të NATO-s) dhe neni IV i Marrëveshjes midis shteteve Palë të Traktatit të Atlantikut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe lidhur me statusin e forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel më 19 qershor 1995 (tani e tutje do të quhet "Marreveshja për Forcat e PfP"), lejojnë rregullime të veçanta shtesë mbi këto marrëveshje;

Duke dëshiruar që të plotësohet Marrëveshja e Statusit të Forcave të PfP, në të cilën të dyja Qeveritë janë palë, dhe që përfshin si referencë Marrëveshjen e Statusit të Forcave të NATO-s dhe çdo marrëveshje tjetër të statusit të forcave në të cilën të dy Qeveritë do të bëhen palë në të ardhmen;

Ranë dakord si më poshtë:

NENI I
PËRKUFIZIME

1. Në funksion të kësaj marrëveshjeje, termi "komponent civil" siç është përcaktuar në nenin 1, paragrafi 1(b) të Marrëveshjes mbi Statusin e Forcave të NATO-s, përfshin punonjësit e organizatave joshqiptare dhe jokomerciale që janë shtetas ose rezidentë të Shteteve të Bashkuara dhe të cilët vetëm për qëllimin e kontributit për mirëqenie, moral apo edukim të forcave amerikane, i shoqërojnë këto forca në Shqipëri. Termi "komponent civil" gjithashtu përfshin vartës të punësuar nga forcat amerikane ose organizatat e referuara më lart dhe në nenin XVIII.

2. Në funksion të kësaj Marrëveshjeje, termat: "kontraktorë të Shteteve të Bashkuara dhe punonjës kontraktorë të Shteteve të Bashkuara" nënkuptojnë kompani dhe firma joshqiptare bashkë me punonjësit e tyre, përveç shtetasve shqiptarë, të punësuar nga Shtetet e Bashkuara në Shqipëri në lidhje me aktivitetet e kësaj marrëveshjeje.

3. Në funksion të kësaj marrëveshjeje, termi "vartës" ashtu siç është përcaktuar në nenin 1, paragrafi 1(c) të Marrëveshjes së Statusit të Forcave të NATO-s, përfshin të afërt të anëtarëve të forcave ose të komponentëve civilë që varen financiarisht, ligjërisht ose për arsye shëndetësore dhe që mbështeten nga ai anëtar, që ndajnë vendbanimin e anëtarit dhe që është prezent në Shqipëri me pranimin e autoriteve të forcës.

4. Në funksion të kësaj Marrëveshjeje termi "detyrim", do të përfshijë detyrimet doganore dhe të gjitha të tjerat, taksat që paguhen mbi importet dhe eksportet, sipas rastit. Nuk do të përfshijë pagesat e shërbimeve të kërkuara apo të realizuara.

NENI II
HYRJA DHE DALJA

1. Në rast se nuk është rënë dakord ndryshe reciprokisht, Shqipëria heq dorë nga autoriteti i saj sipas nenit III, paragrafit 2 (b) të Marrëveshjes së Statusit të Forcave të NATO-s, e cila kërkon kundërfirmën për urdhërat e lëvizjes.

2. Shqipëria nuk do të kërkojë viza për anëtarët e komponentit civil, vartësit dhe punonjësit kontraktorë amerikanë. Autoritetet Shqiptare do të bëjnë shënimet e nevojshme në pasaportat e këtyre personave në përputhje me ligjin shqiptar.

3. Anëtarët e forcës, komponentët civilë dhe vartësit e tjerë përjashtohen nga regjistrimi dhe kontrolli si të huaj.

NENI III
PERDORIMI I OBJEKTEVE DHE ZONAVE.

Forcave Amerikane u autorizohet akses dhe përdorim në ato objekte dhe zona në Shqipëri siç mund të jetë rënë dakort reciprokisht. Personeli ushtarak dhe civil amerikan dhe kontraktorët bashkë me automjetet, anijet, avionët e drejtuar nga ose për Forcat Amerikane, mund t'i përdorin këto objekte dhe zona për stërvitje, tranzit, aktivitete mbështetëse, furnizim të avionëve, mirëmbajtje të përkohshme të automjeteve, anijeve dhe avionëve dhe akomodim të personelit, komunikim, vendosje të forcave dhe materialeve dhe për qëllime të tjera sipas marrëveshjes të të dyja palëve.

NENI IV
JURIDIKSIONI PENAL

1. Shqipëria e pranon rëndësinë e veçantë të kontrollit disiplinor nga autoritetet ushtarake amerikane mbi anëtarët e forcës dhe efektin që ka ky kontroll mbi gatishmërinë operacionale. Duke thelluar angazhimin për mbrojtje të përbashkët, Shqipëria ushtron zgjedhjen sovrane për të hequr dorë nga e drejta parësore për juridiksion gjyqësor, siç parashikohet në paragrafin 3(c) të nenit VII të Marrëveshjes së Statusit të Forcave të NATO-s.

2. Për rregullime të veçanta që lidhen me shkeljet e vogla, Forcat Amerikane do të njoftojne autoritetet kompetente të rasteve individuale sipas parashikimit të paragrafit 1 të këtij neni.

3. Kur autoritetet kompetente shqiptare ruajnë pikëpamjen se për rrethana të caktuara në ndonjë rast specifik, interesat e mëdha të administratës shqiptare të drejtësisë e bëjnë të domosdoshëm ushtrimin e ligjit shqiptar, ata mund të tërheqin lejën e dhënë sipas paragrafit 1 të këtij neni me një njoftim me shkrim për autoritetet kompetente ushtarake amerikane brenda 21 ditëve pas marrjes së njoftimit të parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni.

4. Anëtarët e forcës, komponentët civilë dhe vartësit e tyre nuk do të gjykohen në mungesë pa pëlqimin e tyre.

NENI V
PËRCAKTIMI I JURIDIKSIONIT PENAL

1. Pas njoftimit të autoriteteve kompetente shqiptare nga autoritetet amerikane se ngrihet çështja se cili autoritet do të ushtrojë juridiksionin në lidhje me një shkelje, autoritetet shqiptare që merren me këtë rast do të pezullojnë proçedimin deri sa të arrihet një vendim midis dy Qeverive mbi çështjen e juridiksionit.

2. Në rastin kur një anëtar i forcës, një komponent civil, ose vartës ndiqet nga autoritetet shqiptare, vetëm gjykatat civile me juridiksion të zakonshëm do të kenë kompetencë për të gjykuar individin.

3. Palët konfirmojnë se personeli ushtarak dhe civil i Shteteve të Bashkuara nuk do të dorëzohen apo të transferohen në një gjykatë ndërkombëtare, të ndonjë njësie tjetër apo shteti, pa patur lejen e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

NENI VI
ÇERTIFIKATAT ZYRTARE TË DETYRËS

Kurdo që gjatë proçedimit penal kundër një anëtari të forcës apo një komponenti civil bëhet e nevojshme për të përcaktuar nëse ka lindur ndonjë veprim kriminal ose rrezik potencial publik, gjatë realizimit të detyrës zyrtare, kjo do të vendoset nga autoriteti më i lartë ushtarak përkatës amerikan në Shqipëri, i cili mund t'i japë një çertifikatë gjykatës shqiptare apo autoritetit që merret me këtë çështje. Çertifikata do të konsiderohet si një provë e mjaftueshme sipas paragrafit 3(a), neni VII të NATO SOFA.

NENI VII
NDALIMI DHE AKSESI

1. Dispozitat e ligjit Shqiptar lidhur me paraburgimin ose izolimin e kërkuar të të akuzuarit do të anullohet derisa të vijë

konkluzioni i të gjitha proçedurave gjyqësore me anë të një çertifikate të autoriteteve ushtarake amerikane, që sigurojnë ardhjen e anëtarit të forcës ose komponentit civil përpara autoriteve kompetente shqiptare të drejtësisë në të gjitha seancat ku kërkohet prania e një personi të tillë. Në rast se proçedimet gjyqësore shqiptare nuk përfundojnë brenda një viti, autoritetet ushtarake amerikane do të çlirohen nga çdo detyrim që rrjedh nga ky paragraf.

2. Kur një anëtar i forcës është dënuar nga një trup gjykues shqiptar dhe kur është dhënë dënimi i formës së prerë, autoritetet ushtarake amerikane do ta mbajnë të arrestuar personin deri në përfundimin e proçedurave të apelimit.

3. Periudha e kohës, e kaluar në ndalim nga autoritetet shqiptare ose arrestimi i ushtruar nga autoritetet ushtarake amerikane do të përfshihet në vendimin përfundimtar për ndalim.

4. Në rast se një anëtar i forcës, një komponent civil, apo një vartës arrestohet, ndalohet, apo izolohet nga autoritetet shqiptare, përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara duhet t'u lejohet akses i menjëhershëm tek ky individ kurdo që të kërkohet dhe u lejohet të jenë të pranishëm gjatë marrjes në pyetje nga autoritetet shqiptare.

NENI VIII
BURGOSJA DHE VIZITAT

Burgosja e dhënë nga gjykata shqiptare ndaj anëtarëve të forcës, komponentëve civilë, apo vartësve, do të bëhet në institucionet penale shqiptare që janë përcaktuar për këtë qëllim nga të dyja palët. Autoritetet shqiptare do t'i lejojnë autoritetet amerikane dhe familjet që t'i vizitojnë këto persona në çdo kohë dhe t'i pajisin me mbështetjen, të cilën autoritetet amerikane e konsiderojnë të përshtatshme. Konventa e transferimit të personave të dënuar me 21 mars 1983, do të zbatohet për personat e dënuar nga gjykata shqiptare.

NENI IX
DISIPLINA

1. Autoritet ushtarake amerikane kanë përgjegjësinë për mbajtjen e disiplinës nga anëtarët e forcës.

2. Për thellimin e disiplinës së forcave amerikane, autoritetet ushtarake amerikane mund të kërkojnë vendosjen e njësive të policisë ushtarake në objektet ku janë vendosur forcat amerikane. Autoritetet ushtarake të Shteteve të Bashkuara, gjithashtu mund të autorizojnë përdorimin e njësive te tilla në komunitetet në afërsi të instalimeve ushtarake ku janë vendosur Forcat e Shteteve të Bashkuara, në bashkëpunim me përfaqësuesit zyrtarë të policisë lokale, sipas proçedurave për të cilat kanë rënë dakort autoritetet ushtarake të Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara.

NENI X
SIGURIMI

1. Në përputhje me nenin VII, paragrafi 11, të Marrëveshjes së Statusit të Forcave (SOFA) të NATO-s, Shqipëria duhet të marrë masa të tilla aq sa nevojiten për të siguruar ruajtje dhe mbrojtje adekuate të forcave të Shteteve të Bashkuara, anëtarëve të forcës, komponentit civil dhe vartësve brenda Shqipërisë. Në zbatimin e kësaj përgjegjësie, autoritetet shqiptare do të bashkëpunojnë ngushtë me autoritetet e Shteteve të Bashkuara për t'u bindur që është siguruar ruajtje e mjaftueshme dhe që ka hyrje dhe dalje pa pengesa për dhe nga ambjentet ose rajonet ku janë dislokuar forcat e Shteteve të Bashkuara.

2. Nëse siguria e forcave të Shteteve të Bashkuara, anëtarëve të forcës, komponentit civil, ose vartësve është e rrezikuar, autoritetet ushtarake të Shteteve të Bashkuara mund të marrin masat përkatëse për të mbajtur apo rivendosur rregull dhe disiplinë në ambjentet apo rajonet ku janë dislokuar forcat e Shteteve të Bashkuara.

NENI XI
ANKESAT

1. Anëtarët e forcës dhe të komponentit civil nuk mund të jenë subjekt i ndonjë proçesi për padi civile që ngrihet nga aktet ose neglizhenca që i atribuohet personave të tillë gjatë përmbushjes së detyrës së tyre zyrtare. Padi të tilla mund të prezantohen pranë autoriteteve përkatëse shqiptare dhe të proçedohet në përputhje me dispozitat e nenit VIII të Marrëveshjes së Statusit të Forcave të NATO-s.

2. Ashtu siç përdorët në këtë nen dhe në nenin VIII të Marrëveshjes së Statusit të Forcave të NATO-s, termi "komponenti civil" përfshin gjithashtu shtetas shqiptarë dhe civilët e tjerë të cilët janë të punësuar të Shteteve të Bashkuara, që veprojnë në përmbushjen e detyrës zyrtare të ngarkuar nga forcat e Shteteve të Bashkuara, por nuk përfshin të punësuarit e organizatave kontraktore jo-komerciale.

3. Anëtarët e forcës, ose komponenti civil apo vartësit, nuk mund të vuajnë gjykimet ne mungese ose veprimet hetimore që dëmtojnë interesat e tyre kur detyra zyrtare ose mungesa e autorizuar sipas rregullave pengon përkohësisht pjesëmarrjen e tyre në proçesin jo-penal në të cilin janë palë.

NENI XII
PËRJASHTIMET NGA TAKSAT ZYRTARE

1. Forcat e Shteteve të Bashkuara dhe kontraktorët e tyre, nuk mund të jenë subjekt i taksimit direkt apo indirekt për çështjet që bien në mënyrë ekskluzive brenda sferës së aktiviteteve të tyre zyrtare apo kontraktuese ose që lidhen me materialet e destinuara për aktivitete të tilla. Dërgesat e bëra dhe shërbimet e kryera nga forca ose kontraktorët për anëtarët e forcës, civilët apo vartësit, do të konsiderohen gjithashtu aktivitete te tilla.

Lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar (tvsh), do të aplikohet një përjashtim për artikujt dhe shërbimet e siguruara nga forcat e Shteteve të Bashkuara, ose nga kontraktorët e tyre kur veprojnë për ose në emër të forcave të Shteteve të Bashkuara. Kontraktorët jo-shqiptarë në Shqipëri vetëm për qëllimet e mbështetjes së forcave të Shteteve të Bashkuara nuk do të jenë subjekt i ndonjë forme tatimi mbi të ardhurat ose fitimin nga Qeveria e Shqipërisë apo nëndarjet e saj politike.

2. Avionët e drejtuar nga ose për forcat e Shteteve të Bashkuara nuk do të jenë subjekt i pagesës për uljen ose parkimin, navigacionin apo kalimin në hapësirën ajrore, apo çdo lloj tjetër pagese që lidhet me përmbushjen e misionit që i përket operacioneve të tij ose me përdorimin e ambjenteve, me përjashtim të detyrimeve për shërbimet e kërkuara dhe të përfituara.

3. Dispozitat e ligjeve dhe rregulloreve shqiptare lidhur me mbajtjen e pagesave të tatimeve mbi të ardhurat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, nuk mund të aplikohen për qytetarët e Shteteve të Bashkuara dhe të punësuarit jo-shqiptare të forcave të Shteteve të Bashkuara apo kontraktorëve të Shteteve të Bashkuara që ekskluzivisht i shërbejnë forcës në Shqipëri.

NENI XIII
PËRJASHTIMET NGA TAKSAT PERSONALE

1. Në përputhje me nenin X, dhe në përputhje me nenin XI, paragrafi 2, të Marrëveshjes së Statusit të Forcës të NATO-s, anëtarët e forcës apo të komponentit civil, nuk mund të jenë të detyruar të paguajnë ndonjë taksë apo detyrim tjetër të ngjashëm, përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar në Shqipëri, mbi pronën, pasurinë, përdorimin, transferimin midis tyre, ose transferimin, në rast vdekje, të pasurisë së luajtshme të importuar në Shqipëri apo të fituar atje për përdorim personal. Mjetet e motorizuara në zotërim të një anëtari të forcës, të komponentit civil apo vartësve përjashtohen nga taksat e qarkullimit shqiptar, pagesa për regjistrimin apo liçensën, apo detyrime të ngjashme.

2. Përjashtimi nga taksat mbi të ardhurat që sigurohet nga neni 10 i Marrëveshjes së Statusit të Forcës së NATO-s do të aplikohet gjithashtu për të ardhurat e përfituara nga anëtarët e forcës, komponenti civil apo vartësit si dhe të punësuarit e kontraktorëve të Shteteve të Bashkuara, nga punësimi në organizatat siç referohet në nenin 1, paragrafi 1 dhe neni XVIII i kësaj marrëveshjeje, dhe për të ardhurat që rrjedhin nga burime jashtë Shqipërisë.

NENI XIV
IMPORTI DHE EKSPORTI ZYRTAR

1. Duke ju referuar nenit XI të Marrëveshjes së Statusit të Forcave të NATO-s, importi i pajisjeve, furnizimeve, rezervave ushqimore dhe mallrave të tjera në Shqipëri nga forcat e

Shteteve të Bashkuara ose kontraktorët e Shteteve të Bashkuara, për ose në emër të forcës së Shteteve të Bashkuara përjashtohen nga të gjitha detyrimet. Shtetet e Bashkuara do të jenë përgjegjëse për pagesat e detyrimeve për shërbime të kryera nga Qeveria Shqiptare apo një subjekt politik vetëm në rast se këto lloje shërbimesh janë kërkuar dhe përfituar.

2. Pajisjet, furnizimet, ushqimet dhe mallra të tjera do të përjashtohen nga çdo lloj takse apo detyrimi, i cili ndryshe do të vlerësohej sipas këtyre pronave pas importimit ose blerjes së tyre nga forcat e Shteteve të Bashkuara

3. Eksportimi nga Shqipëria prej trupave të Shteteve të Bashkuara të pajisjeve, furnizimeve, ushqimeve dhe mallrave të tjera, siç referohen në paragrafin 1 të këtij neni do të përjashtohen nga të gjitha llojet e detyrimeve të palës shqiptare. Në raste të veçanta këto prona mund të asgjësohen në Shqipëri sipas termave dhe kushteve, duke përfshirë pagesën e taksave, të detyruara nga autoritetet e Shqipërisë.

4. Përjashtimet e dhëna në paragrafin 1, 2 dhe 3 të këtij neni gjithashtu do të zbatohen për shërbimet, pajisjet, furnizimet, ushqimet dhe prona të tjera të importuara ose të blera në tregun e brendshëm shqiptar nga ose në emër të forcave të Shteteve të Bashkuara për përdorim nga një kontraktor, i cili zbaton një kontratë për këto forca. Forcat e Shteteve të Bashkuara do të bashkëpunojnë plotësisht me autoritetet përkatëse shqiptare për të parandaluar abuzimin ndaj këtyre privilegjeve.

5. Depozita e çertifikatës sipas nenit XI, paragrafi 4, i Marrëveshjes së Statusit të Forcave të NATO-s, do të pranohet në vend të një inspektimi doganor të autoriteteve shqiptare për artikujt e importuar ose të eksportuar nga ose për forcat e Shteteve të Bashkuara, sipas këtij neni.

NENI XV
IMPORTET DHE EKSPORTET PERSONALE

1. Anëtarët e forcës ose komponenti civil dhe vartës dhe nënpunësit kontraktues të Shteteve të Bashkuara mund të importojnë plaçkat e tyre personale, mobilje, automjete private dhe mallra të tjera për qëllime personale ose përdorim familjar ose konsum pa doganë gjatë periudhës së detyrës së tyre në Shqipëri. Ky privilegj do të zbatohet jo vetëm për mallrat që janë pronë e këtyre personave, por edhe për mallra që i dërgohen atyre në formë dhurate ose e dërguar për përmbushjen e kontratës, të përfunduara direkt nga një person ose persona që nuk janë rezidentë në Shqipëri

2. Prona e referuar në paragrafin 1 të këtij neni si dhe mallra të tjera të përftuara pa taksa dhe detyrime, nuk mund të shiten dhe transferohen personave në Shqipëri, të cilët nuk janë të autorizuar të importojnë këto prona pa doganë, në rast se ky transferim nuk është miratuar nga autoritetet përkatëse shqiptare. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e dhuratave për bamirësi. Anëtarët e forcës ose të komponentit civil dhe vartësit

mund të transferojnë lirshëm këto prona midis njëri-tjetrit ose midis forcave dhe këto lloj transferimesh bëhen pa taksa ose detyrime doganore. Forcat e Shteteve të Bashkuara përgjigjen për mbajtjen e të dhënave, të cilat do të konsiderohen si provë nga autoritetet shqiptare të këtyre mallrave të transferuara pa taksa ose detyrime doganore. Autoritetet Shqiptare do të pranojnë si dëshmi kopje të raportimeve të policisë në kohën e duhur si prova të pranueshme që evidentojnë se prona të kaluara pa taksa të pjesëtarëve të forcës apo personelit civil ose vartës në detyrë është vjedhur, që i shpëton këta individë nga detyrimet për të paguar taksa ose detyrime doganore.

3. Pjesëtarët e forcës ose komponentit civil ose vartës dhe zyrtarë kontraktorë të Shteteve të Bashkuara mund të rieksportojnë pa taksa ose detyrime doganore çdo mall që ata kanë importuar në Shqipëri ose që është blerë prej tyre në periudhën e tyre të shërbimit në Shqipëri.

NENI XVI
MJETET E MOTORIZUARA

1. Autoritetet e Shqipërisë respektojnë rregjistrimin dhe liçensimin nga autoritetet civile dhe ushtarake të Shteteve të Bashkuara, të automjeteve të motorizuara dhe të rimorkiove të forcës, ose të kontraktorëve dhe anëtarëve të forcës së Shteteve të Bashkuara ose të komponentit civil ose vartës. Me kërkesë të autoriteteve ushtarake të Shteteve të Bashkuara, autoritetet shqiptare do të lëshojnë targa të liçensuara pa taksë, që janë të njëjta me ato të lëshuara për popullsinë shqiptare në tërësi.

2. Autoritetet ushtarake të Shteteve të Bashkuara do të marrin masa të mjaftueshme sigurie për automjetet e transportit dhe trajlerat e regjistruar dhe të liçensuar prej tyre ose të përdorura nga forcat në Shqipëri.

NENI XVII
PATENTAT E SHOFERËVE

1. Çdo liçencë apo leje tjetër e lëshuar një pjesëtari të forcave apo komponentit civil ose punonjësve kontraktues të Shteteve të Bashkuara nga autoritetet ushtarake të tyre që i njeh ata si zotërues të përdorimit të automjetit, anijes apo avionit të forcave, është i vlefshëm për përdorimin e tyre edhe në Shqipëri.

2. Autoritetet e Shqipërisë do të respektojnë patentat e drejtimit të automjetit të lëshuara nga autoritetet ushtarake dhe civile të Shteteve të Bashkuara për drejtimin e automjeteve private nga anëtarët e forcës ushtarake të komponentit civil ose vartës, në rast se këto autoritete kanë përcaktuar se përveç aftësisë për të drejtuar një automjet, aplikantët zotërojnë njohuri të mjaftueshme të rregullave të trafikut shqiptar. Në këto raste nuk do të kërkohet patenta ndërkombëtare e shoferit.

3. (A) Autoritetet ushtarake të Shteteve të Bashkuara do të grumbullojnë patentat e shoferit të vlefshme në Shqipëri në përputhje me paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni, në rast se kanë

dyshime të mjaftueshme të paaftësisë së personave për të drejtuar automjetin. Ato do të japin vlerësime dashamirëse ndaj kërkesave të bëra nga autoritetet shqiptare për marrjen e këtyre patentave të shoferit. Autoritetet ushtarake të Shteteve të Bashkuara do të njoftojnë autoritetet shqiptare për të gjitha tërheqjet e bëra, në përputhje me këtë nënparagraf dhe për të gjitha rastet ku pas marrjesh të tilla, patenta e shoferit është ridhënë.

(B) Në rastet kur gjykatat shqiptare ushtrojnë juridiksion në përputhje me nenin VII të Marrëveshjes së Statusit të Forcave të NATO-s, dhe nenit III të kësaj Marrëveshje lidhur me shkeljet gjatë përdorimit të automjetit, dispozitat e ligjit penal shqiptar për marrjen e lejes së liçencës mbeten në fuqi për patentat që i referohen paragrafit 2 të këtij neni.

NENI XVIII
PROCEDURA DOGANORE

1. Shqipëria do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar një kalim të qetë dhe të shpejtë nga autoritetet doganore shqiptare të importeve dhe eksporteve të trupave të kontraktorëve amerikanë, pjesëtarëve të forcës si dhe komponentit civil apo vartës.

2. Inspektimi doganor sipas kësaj Marrëveshjeje do të kryhet në objekte në përputhje me proçedurat e miratuara në mënyrë reciproke nga autoritetet përkatëse shqiptare dhe Forcat e Shteteve të Bashkuara. Çdo inspektim nga autoritetet doganore shqiptare i pronave personale të anëtarëve të forcës, komponentit civil apo vartës, që hyjnë ose që dalin, do të kryhet kur prona është dërguar ose marrë nga rezidenca e personit.

3. Autoritetet ushtarake të Shteteve të Bashkuara do të vendosin kontrolle të nevojshme doganore nëpër pikat ku janë vendosur forcat e Shteteve të Bashkuara për të parandaluar abuzimet ndaj të drejtave të garantuara sipas Marrëveshjes së Statusit të Forcave të NATO-s dhe sipas kësaj Marrëveshje. Autoritetet ushtarake amerikane dhe shqiptare do të bashkëpunojnë në hetimin e ndonjë sulmi të supozuar ku përfshihet edhe dhunimi doganor.

NENI XIX
VEPRIMTARI TË SHËRBIMEVE USHTARAKE

1. Autoritetet ushtarake të Shteteve të Bashkuara mund të vendosin, mbajnë dhe zhvillojnë shkëmbime të shërbimeve ushtarake, markete, pika shitjeje, menca të hapura, qendra sociale dhe arsimore, si dhe qendra argëtimi në Shqipëri për përdorim nga anëtarët e forcës, komponentit civil apo vartës.

2. Organizimet dhe veprimtaritë siç referohen në paragrafin 1 të këtij neni janë pjesë integrale e forcave të Shteteve të Bashkuara dhe do t'u jepen në përputhje me të njëjtat përjashtime fiskale dhe doganore duke përfshirë edhe ato që jepen në nenin 12 dhe 14 të kësaj marrëveshjeje.

3. Autoritetet ushtarake të Shteteve të Bashkuara do të adaptojnë masa përkatëse për të parandaluar shitjen e mallrave dhe pasurisë të importuara ose të blera në Shqipëri nga organizmat siç referohen në paragrafin 1 të këtij neni për personat e paautorizuar për të mbrojtur këto organizma.

NENI XX
ZYRAT E POSTËS USHTARAKE

1. Shtetet e Bashkuara mund të vendosin, mbajnë dhe vënë në funksionim zyra të postës për përdorim nga forca, zyrtarët kontraktues të Shteteve të Bashkuara, anëtarët e forcës, ose komponenti civil, pensionistët e forcave të armatosura të Shteteve të Bashkuara, dhe të vartësve.

2. Posta e dërguar në zyra të tilla postare mund të mbajë pullat e Shteteve të Bashkuara.

3. Posta zyrtare e forcës do të përjashtohet nga kontrolli ose sekuestrimi nga autoritetet shqiptare.

NENI XXI
VALUTA DHE KËMBIMI

1. Forca e Shteteve të Bashkuara do të ketë të drejtën të importojë, eksportojë dhe përdorë valutën e Shteteve të Bashkuara ose instrumenta të shprehura në valutën e Shteteve të Bashkuara në çdo sasi.

2. Autoritetet ushtarake të Shteteve të Bashkuara mund të shpërndajnë ose këmbejnë për anëtarët e forcës, komponentin civil dhe vartësit valutë dhe instrumenta të emërtuara në valutën e:
(a) Shteteve te Bashkuara;
(b) Shqipërisë;
(c) Euro; dhe
(d) Çdo vendi tjetër, në masën e kërkuar për qëllim udhëtimi të autorizuar, duke përfshirë udhëtimin me leje.

3. Një anëtar i forcës, komponenti civil dhe vartësit mund të:

(A) Importojë valutën e Shteteve të Bashkuara dhe instrumenta të emërtuara në valutën e Shteteve të Bashkuara; dhe

(B) Të eksportojnë çdo valutë tjetër përveç asaj të Shqipërisë, dhe instrumenta të emërtuara në çdo valutë të tillë, me kusht që çdo anëtar i tillë ose vartës, të ketë importuar valutë ose instrumenta të tillë ose të ketë marrë valutë ose instrumenta te tillë nga autoritetet ushtarake të Shteteve të Bashkuara.

4. Autoritetet e Shteteve të Bashkuara, në bashkëpunim me autoritetet e Shqipërisë, do të marrin masat e nevojshme për të parandaluar çdo abuzim të të drejtave të garantuara nga ky nen dhe për të mbrojtur sistemin e rregulloreve të Shqipërisë për

këmbimin e valutës së huaj për sa kohë ato zbatohen për personelin që mbulon kjo marrëveshje.

NENI XXII
PROÇEDURAT KONTRAKTUESE

1. Në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Shteteve të Bashkuara, forcat e Shteteve të Bashkuara mund të japin si shpërblim kontrata për blerjen e artikujve dhe shërbimeve, duke përfshirë ndërtime, në Shqipëri. Forcat e Shteteve të Bashkuara mund të prokurojnë nga çdo burim.

2. Forcat e Shteteve të Bashkuara mund të kryejnë ndërtime me personelin e tyre.

3. Individëve, prania e të cilëve në një vepër kërkohet për përmbushjen e kontratës, duhet t'i garantohet hyrja në Shqipëri brenda shtatë (7) ditë pune nga paraqitja e kërkesës nga autoritetet e Shteteve të Bashkuara. Një hyrje e tillë mund të mohohet ose tërhiqet për arsye të sigurisë ose të sjelljes jokorrekte të individëve. Në qoftë se autoritetet përkatëse shqiptare mohojnë ose tërheqin një hyrje të tillë, ata duhet të paraqesin me shkrim arsyet për vendimin e tyre autoriteteve përkatëse ushtarake të Shteteve të Bashkuara.

4. Shqipëria duhet t'i japë forcës trajtimin për çështje të prokurimit të mallrave, shërbimeve dhe lehtësi që të jetë jo më pak favorizues se sa trajtimi i dhënë Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

NENI XXIII
STATUSI I KONTRAKTORËVE

Qytetarët dhe firmat e Shteteve të Bashkuara, dhe shtetasit, firmat dhe korporatat e vendeve të treta që i shërbejnë ekskluzivisht forcës së Shteteve të Bashkuara duhet të përjashtohen nga ligjet dhe rregulloret e Shqipërisë, ose çdo pjesë të tyre, lidhur me kushtet dhe konditat e punësimit dhe liçensimit të tyre dhe regjistrimin e biznesit dhe korporatave. Kontraktorë të tillë do të përjashtohen gjithashtu nga të gjitha taksat mbi të ardhurat dhe të korporatës, që burojnë nga dërgimi forcave të Shteteve të Bashkuara të mallrave dhe shërbimeve, ose nga ndërtimi i ambienteve.

NENI XXIV
SHËRBIMET DHE KOMUNIKIMI

1. Personeli ushtarak dhe civil i Shteteve të Bashkuara, dhe kontraktorët mund të përdorin ujë, elektricitet dhe shërbime të tjera publike me kushtet dhe konditat, duke përfshirë çmimet dhe detyrimet, jo më pak favorizuese se sa ato që përdoren për Forcat e Armatosura ose Qeverinë Shqiptare, në rrethana të ngjashme, nëse nuk është rënë dakord ndryshe. Kostot për forcat e Shteteve të Bashkuara do të jenë të barabarta me pjesën e tyre proporcionale të kostos për furnizime të tilla.

2. Forcat e Shteteve të Bashkuara do të lejohen të përdorin sistemet e tyre të telekomunikacionit (sipas përcaktimit të termit "telekomunikacion" në Kushtetutën e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit të vitit 1992). Kjo do të përfshijë të drejtën për përdorimin e këtyre mjeteve dhe shërbimeve siç janë kërkuar për të siguruar aftësi të plotë për operimin e sistemeve të telekomunikimit, dhe të drejtën për të përdorur pa pagesë të gjithë spektret e radios të nevojshme për këtë qëllim. Forcat e Shteteve të Bashkuara, me qëllim për të shmangur interferencat e ndërsjellta të ndërprerjes, si edhe për të asistuar Shqipërinë në plotësimin e detyrimeve të saj ndërkombëtare, do të bëjë çdo përpjekje të mundshme për të koordinuar përdorimin e frekuencave me autoritetet shqiptare. Forcat e Shteteve të Bashkuara do të marrin në konsideratë ligjet shqiptare dhe do të konsultohen me autoritetet përkatëse shqiptare në operimin e sistemeve të tyre telekomunikuese.

NENI XXV
HYRJA NË FUQI DHE KOHËZGJATJA

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën që Shqipëria do të njoftojë Shtetet e Bashkuara të Amerikës përmes kanaleve diplomatike, se të gjitha proçedurat e brendshme të nevojshme për t'i dhënë fuqi kësaj Marrëveshje në Shqipëri kanë përfunduar. Kjo marrëveshje do të qëndrojë në fuqi për një periudhë kohe të pacaktuar.

Secila palë mund të përfundojë këtë Marrëveshje brenda gjashtë muaj të njoftimit me shkrim të palës tjetër përmes kanaleve diplomatike.

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim nga palët.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar nga qeveritë e tyre respektive, kane nënshkruar këtë Marrëveshje.

Përfunduar në Tiranë, më 31 mars, 2004, duplikuar në gjuhët angleze dhe shqipe, të dy tekstet janë njëlloj autentik.

PËR QEVERINË E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË